

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-07

Prokurori k. Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt

Për: Panelin e Gjykatës së Apelit

Gjykatëse Mishelë Pikar

Gjykatës Emilio Gati

Gjykatës Nina Jorgensen

Administratorja: Dr. Fidelma Donlon

Parashtrues: Mbrojtësi i specializuar për Hysni Gucatin

Data: 4 gusht 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Version i Redaktuar Publik i Kundërpërgjigjes ndaj Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Apeleve të Mbrojtjes Kundër Vendimit në lidhje me Nxjerrjen e Materialit

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësve të Hysni Gucatit

Xhonatan Elistan Ris

Hju Bauden

Mbrojtësve të Nasim Haradinajt

Tobi Kadman

Karl Bakli

I. HYRJE

1. Më 8 korrik 2021, i akuzuari mori njoftim se Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") kishte dorëzuar një parashtrim ("përgjigja")¹ ku kërkonte që të hidhej poshtë "apeli"² i të akuzuarit.
2. I akuzuari i kundërpërgjigjet përgjigjes, në përputhje me rregullën 9 dhe 76 të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), pa cenuar parashtrimet e dorëzuara në apel dhe pranon se Paneli merr në shqyrtim kundërpërgjigjen ose pjesë të saj vetëm nëse kanë të bëjnë me çështje të reja që dalin nga përgjigja.

II. PARASHTRIMET

3. I akuzuari pajtohet me ZPS-në se zgjidhja përfundimtare e argumenteve të Mbrojtjes për nxitje ose shtytje për kryerje të veprës penale do të jepet në gjyq³.
4. Megjithatë, nxjerrja në kohë e materialit është e nevojshme për përgatitjen e shpejtë të çështjes për gjykim dhe nuk duhet të pritët deri në fillimin e gjykimit për ta bërë këtë.

¹ Përgjigje ndaj apeleve të Mbrojtjes kundër vendimit në lidhje me nxjerrjen me një shtojcë konfidenciale, KSC-BC-2020-07/IA005/F00005, 8 korrik 2021, konfidenciale.

² Njoftim për apel të ndërmjetëm lejuar në bazë të vendimit KSC-BC-2020-07/F00210 në pajtim me nenin 45(2) dhe rregullën 170(2), KSC-BC-2020-07/IA005/F0002, 25 qershor 2021, konfidencial.

³ Përgjigja, para. 23, poshtëshënimi 51

5. Në pajtim me urdhrin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake⁴, i akuzuari e ka dorëzuar dosjen paraprake të Mbrojtjes⁵. Brenda dosjes paraprake të Mbrojtjes, i akuzuari ka përmendur në paragrafët 36 deri në 50, 89, 107, 116 deri në 119, 134 deri në 136, 164, 175, 176, 179, 310, 341 to 343, 349, 393 deri në 395, dhe nga 397 deri në 404, disa nga çështjet që i akuzuari do të ngrejë në gjykim lidhur me nxitjen⁶.
6. Në përputhje me këtë, kundërshtohet edhe sugjerimi i ZPS-së se çështja e nxitjes është e pabazuar. Sidoqoftë, edhe ZPS-ja pajtohet se zgjidhja përfundimtare lidhur me argumentet e Mbrojtjes për nxitje ose shtytje për kryerje të veprës penale do të jepet në gjyq⁷.
7. Në lidhje me paragrafin 19 të përgjigjes, pretendimi i ZPS-së se nuk zotëron asnjë informacion për ndonjë person që ka lidhje me ZPS-në, që të ketë “lëshuar” ose, nëpërmjet cilësdo formë tjetër, t’u ketë dhënë paketa me materiale ndonjë personi të tretë, është thjesht i pasaktë.
8. ZPS-ja zotëron ERN 091815-091816 dhe ERN 091830-091831; [REDAKTUAR].
9. Gjithashtu, ZPS-ja zotëron ERN 081381-081391, ku përmendet se një gazetar ka marrë një kopje “të një produkti të punës së brendshme”, që mendohet se është pjesë e paketës 3, nga një “burim në Zyrën e Prokurorisë së Specializuar në Hagë”.

⁴ KSC-BC-2020-07/F00244, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, “Urdhër për dorëzimin e Aktakuzës së korrigjuar dhe për një kalendar të dytë të rishikuar për pjesën e mbetur të procedurës paraprake”, 23 qershor 2021, publik, para. 17 dhe 22(b).

⁵ KSC-BC-2020-07/F00258, “Dosja paraprake e mbrojtjes në emër të Hysni Gucatit”, dhe shtojcat A01, A02 dhe A03, 12 korrik 2021, konfidenciale.

⁶ Shih gjithashtu KSC-BC-2020-07/F00199, “Përgjigje ndaj versionit të redaktuar konfidencial të ‘kërkesave dhe kundërshtimeve të Prokurorisë në pajtim me KSC-BC-2020-07/F00172’, KSC-BC-2020-07/F00190 datë 26 prill 2020”, 10 maj 2021, konfidenciale, para. 34 deri në 47.

⁷ Përgjigjja, para. 23, poshtëshënimi 51.

10. Pohimet shpërfillëse mbështetur në parashtrime me shkrim dhe jo në prova, janë mënyrë e papërshtatshme për të kryer procesin e nxjerrjes së materialit.
11. Mundet që ZPS-ja ta ketë bërë pohimin sa më lart (i) pa pasur dijeni që kishte në zotërim ERN 091815-09186, ERN 091830-091831 dhe ERN 081381-081391 ose (ii) refuzon përfundimin që nxjerr Mbrojtja nga këto dokumente (megjithëse këto përfundime i kanë të qarta para syve) dhe, rrjedhimisht, i shpërfill ato. Megjithatë, cilado qoftë qasja, ajo përbën një shqetësim real dhe të dukshëm.
12. Diskutimet mbi peshën që do t'u jepet provave dhe përfundimet e duhura lidhur me to janë përgjegjësi e Trupit Gjykues dhe jo e ZPS-së.
13. Pretendimi në paragrafin 29 të përgjigjes se “nuk ka arsye që në njoftimin sipas rregullës 102(3) të jepet një listë e provave në rastet kur tashmë është e qartë se ato nuk janë juridikisht thelbësore për përgatitjen e mbrojtjes” është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me kriterin e rregullës 102(3) (i cili nuk përcakton përjashtime të tilla) dhe përpiket që në mënyrë të papërshtatshme të anashkalojë vendimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake (që nuk është apeluar nga ZPS-ja) sipas të cilit njoftimi i hollësishëm nuk duhet të përmbajë vetëm informacionin që vlerëson ZPS-ja se mund të jetë juridikisht thelbësor për përgatitjen e mbrojtjes, por *çdo* material dhe provë që zotëron ZPS-ja, që nuk është nxjerrë në përputhje me rregullën 102(1)(a)-(b) dhe 130 dhe që ka lidhje me çështjen (sipas rregullës 106)⁸.
14. ZPS-ja duket se refuzon të pranojë qëllimin e njoftimit sipas rregullës 102(3) ku thuhet se ‘Prokurori i Specializuar i jep njoftim të hollësishëm Mbrojtjes për çdo material dhe provë që ka në zotërim , të cilat nuk janë nxjerrë, për të

⁸ KSC-BC-2020-07/F00172, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për rëndësinë materiale të informacionit të kërkuar në përputhje me rregullën 102(3) dhe çështje të lidhura me të*, 1 prill 2021, konfidencial, para. 23.

ndihmuar Mbrojtjen të kërkojë informacionin që ajo e vlerëson se është juridikisht thelbësor për përgatitjen e vet⁹.

15. Pretendimi i ZPS-së se nuk sheh asnjë arsye pse duhet t'u përmbahet kriterëve të rregullës 102(3) dhe vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake përbën shqetësim real dhe të dukshëm.
16. Në kundërshtim me pretendimin në paragrafin 32 të përgjigjes, nuk ishte "e pamundur" për Gjykatësin e Procedurës Paraprake që të shqyrtonte materialet e kërkuara.
17. I akuzuari kërkoi çfarëdo materiali që ka ZPS-ja që lidhet me origjinën dhe prejardhjen e materialeve që përmbajnë tri paketat, përfshi këtu edhe materialet për autorësinë dhe kronologjinë e mbajtjes në ruajtje, qysh nga hartimi e deri te mbërritja e tyre në OVL-UÇK ("kërkesa B e Gucatit"). ZPS-ja asnjëherë nuk ka sugjeruar se nuk i ka këto materiale (do të ishte absurde ta bënte këtë).
18. I akuzuari kërkoi çfarëdo materiali që ka ZPS-ja që ka të bëjë me përpjekjet e kryera prej saj për të identifikuar dhe gjurmuar individët që i kanë dhënë tri paketat OVL-UÇK-së ("kërkesa C e Gucatit"). Megjithëse është e mundur, ZPS-ja nuk ka sugjeruar asnjëherë se nuk i ka këto materiale.
19. Për sa i përket "materialit që lidhet me paketën 3 [REDAKTUAR], i akuzuari kërkoi informacionin konkret¹⁰:

⁹ KSC-BC-2020-07/F00172, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për rëndësinë materiale të informacionit të kërkuar në përputhje me rregullën 102(3) dhe çështje të lidhura me të*, 1 prill 2021, konfidencial, para. 23.

¹⁰ KSC-BC-2020-07/F00199, "Përgjigje ndaj versionit të redaktuar konfidencial të 'kërkesave dhe kundërshtimeve të Prokurorisë në pajtim me KSC-BC-2020-07/F00172', KSC-BC-2020-07/F00190 datë 26 prill 2020", 10 maj 2021, konfidencial, para. 49.

- a. Cilët punonjës ose ish-punonjës të ZPS-së (ku përfshihen hetues dhe avokatë) kanë ndihmuar në hartimin e materialit?
- b. Cilët punonjës ose ish-punonjës të ZPS-së (ku përfshihen hetues dhe avokatë) kanë pasur qasje në dokument në mënyrë elektronike?
- c. Cilët punonjës ose ish-punonjës të ZPS-së (ku përfshihen hetues dhe avokatë) kanë pasur qasje në dokumentin fizik?
- d. A ka qenë i mbrojtur me fjalëkalim dokumenti? Në rast se po, cilët punonjës ose ish-punonjës të ZPS-së (ku përfshihen hetues dhe avokatë) e kanë pasur fjalëkalimin?
- e. A punojnë ende për ZPS-në punonjësit që kanë pasur qasje në dokument (ose që kanë pasur fjalëkalime)?
- f. A ka ZPS-ja ende një kopje elektronike të dokumentit?
- g. A janë bërë kërkime në meta të dhënat për të gjetur prova se cili ka qenë personi i fundit që ka pasur qasje në dokument? Në rast se po, cili ka qenë ky person?
- h. A i ka identifikuar ZPS-ja kompjuterin/kompjuterat që janë përdorur për hartimin e dokumentit? Cili është/cilët janë përdoruesit e rregullt të këtyre kompjuterave? Ku ishin të vendosura këto pajisje?
- i. A është intervistuar ndonjë punonjës apo ish-punonjës i ZPS-së lidhur me nxjerrjen e dokumentit?
- j. A është intervistuar ndonjë punonjës apo ish-punonjës i ZPS-së lidhur me nxjerrjen e dokumentit?

- k. A janë analizuar të dhënat e ndonjë prej pajisjeve elektronike që përdorej ose ishte nën kontrollin e punonjësve ose ish-punonjësve të ZPS-së për të gjetur prova për nxjerrjen e dokumentit?
- l. A janë analizuar të dhënat e ndonjë prej adresave të postës elektronike apo mjete të tjera të komunikimit elektronik, që përdorshin ose ishin nën kontrollin e punonjësve ose ish-punonjësve të ZPS-së për të gjetur prova për nxjerrjen e dokumentit?
- m. A ka pasur kopje fizike të dokumentit të ruajtura në mjediset e ZPS-së? Në rast se po, a ka pasur mbulim me kamera sigurie në zona/zonat ku ruhej materiali ose rrugët që të çonin në këtë zonë apo ato zona? Në rast se po, a janë analizuar filmimet nga kamerat e sigurisë për të gjetur prova të hyrjes dhe daljes nga zona(t) në fjalë?
20. Asnjëherë nuk është sugjeruar nga ZPS-ja se nuk e ka këtë informacion.
21. Ishte krejt e mundur për Gjykatësin e Procedurës Paraprake që të shqyrtonte materialin dhe informacionin e kërkuar. Sugjerimi se kryerja e një shqyrtimi të tillë ishte e pamundur është tërësisht çorientues. i tillë është i pamundur është tërësisht. Është tërësisht çorientuese të sugjerohet se ishte e pamundur të kryhej shqyrtimi.
22. Bërja e pohimeve çorientuese nga ZPS-ja shkakton shqetësime reale dhe të dukshme (aq më tepër kur bëhen në mënyrë të përsëritur).
23. Në vend që të merret me hiperbolë dhe histerizëm në parashtrimet e saj në paragrafët 35 deri në 236 të përgjigjes, ZPS-ja duhet të angazhohet në mënyrë

konstruktive për nxjerrjen e informacionit për të mundësuar përgatitje të shpejtë të çështjes për gjykim.

24. Për arsyet e parashtruara në apel, Panelit të Gjykatës së Apelit i kërkohet të miratojë apelin, plotësisht ose pjesërisht,, , dhe:

- a. Të urdhërojë nxjerrjen e të gjithë materialit të përmendur në kërkesat B-C e Gucatit; ose
- b. Të urdhërojë që në njoftimin e hollësishëm sipas rregullës 102(3) të përfshihet një listë e të gjitha materialeve të kërkuara në kërkesat B-C të Gucatit.

III. KLASIFIKIMI

25. Në pajtim me rregullën 82(4) të Rregullores, kjo kundërpërgjigje klasifikohet si konfidenciale. Nuk ka asnjë kundërshtim për riklasifikimin e kundërpërgjigjes si publike.

Numri i fjalëve në origjinal: 1557

/nënshkrimi/

XHONATAN ELISTAN RIS

Mbrojtësi i specializuar për z. Gucati

HJU BAUDEN

Bashkëmbrojtës i specializuar për z. Gucati

13 korrik 2021

Kardif, Britani e Madhe